

FTESE KONVENTA KOMBETARE PER INTEGRIMIN EUROPIAN & PLATFORMA E PARTNERITETIT PER INTEGRIMIN EUROPIAN

KAPITULLI 23 – GJYQESORI DHE TE DREJTAT THEMELORE TEMA: PREZANTIMI I STRATEGJISE NDERSEKTORIALE TE DREJTËSISE 2024-2030

E mërkurë, 2 tetor 2024, 10:00 – 11:15
Tirana International Hotel, Classic Room

Në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian dhe Konventës Kombëtare për Integrimin Europian, Ministria e Drejtësisë së bashku me Lëvizjen Europiane në Shqipëri kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në këtë Tryezë Diskutimi për Kapitullin 23 mbi prezantimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 -2030, mbështetur nga Bashkimi Europian.

Ministria e Drejtësisë ka përfunduar procesin e draftimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, hartuar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe që përmban objektivat më të rëndësishme dhe rezultatet e pritshme për 7 (shtatë) vitet e ardhshme. Ky dokument i rëndësishëm u hartua me asistencën teknike të Projektit JustAL.

Në Strategjinë e re theksi vendoset tek konsolidimi i kuadrit ligjor dhe qëndrueshmëria e arritjeve të Reformës në Drejtësi në përputhje me acquis të BE, eliminimi i backlog-u dhe rritja e efikasitetit, rritja e cilësisë së shërbimeve, duke u përqëndruar gjithashtu dhe në konsolidimin e kuadrit institucional dhe përmirësimin e infrastrukturës së sistemit të drejtësisë dhe forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës.

Në këtë kuadër, me qëllim gjithëpërfshirjen ky takim duke ofruar një hapësirë diskutimi dhe ndarje mendimesh, synon mbledhjen e opinioneve të aktorëve të shoqërisë civile të cilët me eksperiencën dhe ekspertizën në këtë fushë të ofrojnë kontribute të vlefshme dhe të nevojshme në kapërcimin e sfidave dhe përmirësimin e procesit.

Dokumentin e Draft-Strategjisë mund ta gjeni në faqen online për konsultimin publik: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/780>

Duke vlerësuar pjesëmarrjen tuaj në takim, ju mirëpresim!

**PROGRAMI
KONVENTA KOMBETARE PER INTEGRIMIN EUROPIAN
&
PLATFORMA E PARTNERITETIT PER INTEGRIMIN EUROPIAN**

**KAPITULLI 23 – GJYQESORI DHE TE DREJTAT THEMELORE
TEMA: PREZANTIMI I STRATEGJISE NDERSEKTORIALE TE
DREJTËSISE 2024-2030**

**E mërkurë, 2 tetor 2024, 10:00 – 11:15
Tirana International Hotel, Classic Room**

10:00–10:15 **Regjistrimi i pjesëmarrësve**

10:15–10:20 **Fjala e hapjes**

Moderator: Znj. Elona Bano
Drejtor i Integrimit dhe Negociatave

10:20–10:30 **Risitë e Strategjisë së re në kuadër të sfidave të
procesit të integrimit evropian**

Z. Tedi Dobi
Zëvendësministër i Drejtësisë

10:30 – 10:40 **Prezantimi dhe qëllimet kryesore të politikës së
Strategjisë së re**

Z. Artan Kotro
Drejtor i Përgjithshëm

10:40 – 11:15 **Diskutime me aktorë të shoqërisë civile dhe anëtarë të
PPIE dhe përfundime**